



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2551/ 14 prot.

Datë 27.11.2025

V E N D I M
Nr. 1765/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1610/2025, datë 07.11.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt “Ndërtim Rrugët Blloku 1 Frutikulturë”, me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues: BOE “KUPA” shpk (përfaqësues) me NIPT K51615512C dhe adresë: Kamez Tirane Kamez, KAMEZ, Rruga Berisha, Argjjinatura me nr.pasurie 482, Çerkeze & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Subjekt i interesuar: BOE “Shëndelli” Shpk (përfaqësues) me NUIS K07924803N me adresa: MALLAKASTER Fier Fier Fier, FIER, Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier & “Mateo” SHPK.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 07.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1610/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt “Ndërtim Rrugët Blloku 1 Frutikulturë”, me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.*

2. *Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.*

3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*

4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk.*

5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 9962/1prot., datë 17.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2551/11 prot., datë 19.11.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1610/2025 datë 07.11.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt “Ndërtim Rrugët Blloku 1 Frutikulturë”, me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 9962/1prot., datë 17.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2551/11 prot., datë 19.11.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1610/2025 datë 07.11.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt "Ndërtim Rrugët Blloku 1 Frutikulturë", me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.1610/2025 datë 07.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës objekt ankimi, në zbatim të vendimit Nr.1610/2025 datë 07.11.2025, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt "Ndërtim Rrugët Blloku 1 Frutikulturë", me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

